



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Datë: 29.11.2023

# DIMRI KULTUROR

Thirrje për shfrytëzimin e shtëpizave të drurit

## QËLLIMI

Festat e fundvitit në gjithë botën sjellin atmosferën festive, prandaj dhe në Prizren ashtu siç është bërë traditë tashmë do të organizohen aktivitete kulturore nga Komuna e Prizrenit për qytetarët e vendit dhe turistët, gjatë ditëve festive të dhjetorit. Këto aktivitete ju ofrojnë mundësi bizneseve të vogla të qytetit që të ofrojnë shërbimet e tyre në shesh, në shtëpizat e drurit të cilat do të vendosen në sheshin e Lidhjes.

## RREGULLAT E PUNËS

### 1) Vendi dhe orari i punës

Hapja zyrtare e Festimit të Festave të Fundvitit do të bëhet do të bëhet me datën 20.12.2023 (nëse çdo gjë shkon sipas planifikimeve) dhe mbaron me datën 06.01.2024. Të gjithë bizneset e përzgjedhura duhet të respektojnë datat e hapjes dhe mbylljes të përcaktuara nga Komuna e Prizrenit, nëse nuk e respektojnë datën e hapjes, në formë automatike e humbasin të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës.

Gjatë kësaj kohe bizneset e përzgjedhura për shtëpiza obligohen të punojnë çdo ditë, nga e hëna në të dielën duke filluar prej orës 12:00 deri në orën 24:00. Hapja e shtëpizave mund të bëhet më herët, por asnjëherë më vonë se ora e paracaktuar. Çdo biznes që e hap shtëpizën pas orës 12:00, e humbet të drejtën e shfrytëzimit të shtëpizës menjëherë.

### 2) Kriteret e aplikimit dhe operimit

Përzgjedhja e bizneseve të cilat do të shfrytëzojnë shtëpizat do të bëhet nga komisioni në Komunën e Prizrenit.

Numri i shtëpizave do të jetë i kufizuar. Aplikimi i kriterëve si më poshtë do të jetë përcaktues në mënyrë që përzgjedhja e bizneseve të jetë sa më adekuate:



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

Datë: 29.11.2023

---

- Bizneset do të aplikojnë për produkte ushqimore (specifikisht pjata shoqëruese për pije të ftofta dhe të ngrohta – meze), laramani të pijeve si dhe idetë ndryshme të realizueshme me motive dimrore;
- Bizneset aplikuese duhet të jenë të regjistruara në Administratën Tatimore të Kosovës, me adresë operimi në Komunën e Prizrenit;
- Bizneset aplikuese duhet të paraqesin ofertën me çmimore për artikujt;
- Bizneset e përzgjedhura do t'a kenë obligative që afër shtëpizës t'a kenë shportën për mbeturinat personale;
- Bizneseve të përzgjedhura do t'u lejohen numër i caktuar i shankerica dhe bureve para shtëpizave të tyre;
- Bizneset e përzgjedhura duhet të sjellin deklaratën nga ATK se nuk kanë obligime tatimore të papaguara;

### **3) Përparësi në përzgjedhje do të kenë**

- Bizneset të cilat promovojnë përdorimin e produkteve lokale/vendore sipas pikës 2.1.;
- Bizneset që ofrojnë produkte ushqimore inovative në fushën e gastronomisë dhe produkte që kanë të bëjnë me motive të stinës së dimrit;
- Bizneset të cilat dorëzojnë formën e aplikimit të parat që nga data e njoftimit.
- Lokacionet e shtëpizave do të vendosen nga Komuna e Prizrenit, në bazë të planifikimeve për gjithë përfshirje.

### **4) Kodi mirësjelljes dhe obligimet shtesë**

Të gjitha bizneset janë të obliguara të tregojnë frymë bashkëpunimi të mirëfilltë në mes tyre. Në mënyrë që ky bashkëpunim të jetësohet sa më mirë, Komuna e Prizrenit gjatë ditëve të organizimeve obligon bizneset dhe ndalon rreptësisht aktet si më poshtë:

- Kryerjen e akteve të paligjshme dhe të dhunshme brenda zonave; Abuzimin verbal ose fizik të personave.



Republika e Kosovës  
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti



Komuna e Prizrenit  
Opština Prizren — Prizren Belediyesi

**Datë: 29.11.2023**

- Shitjen e produkteve të cilat nuk janë paraparë të shiten në asnjërën prej shtëpizave.
- Obligohen të gjitha bizneset e përzgjedhura që pas përfundimit të orarit të punës ta pastrojnë shtëpizën e tyre dhe hapësirën rreth tyre; Hudhja e mbeturina do të bëhet nga ana e biznesit përfituese në vendet e caktuara për hudhje. Ankesa e përsëritur dy herë për mos pastrim të hapësirës, përkon me shkëputjen e menjëhershme të marrëveshjes dhe marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të shtëpizës.
- Muzika dhe performancat gjatë gjithë kësaj periudhe do të jetë e organizuar dhe e përbashkët. Muzika dhe performancat individuale të bizneseve në shtëpizat e tyre është e ndaluar rreptësisht.

### **5) Mënyra e Aplikimit**

- Plotësimi i aplikacionit të bashkangjitur.
- Aplikuesit në aplikacion duhet ti bashkëngjisin dokumentet përcjellëse: **kopjet e certifikatës së regjistrimit të biznesit, deklaratën nga ATK dhe kopjen e letërnjoftimit të personit që aplikon.**
- Aplikuesit për shtëpizat e destinuar për pije të ftohta, të ngrohta dhe ushqime duhet ta dorëzojnë **menu të pijeve dhe të ushqimit me çmime,**
- Aplikuesit kanë të drejtë aplikimi vetëm një herë me **kartelën identifikuese** të një personi juridik;
- Afati për aplikim: **29 Nëntor — 05 Dhjetor 2023** prej orës **08:30 - 15:00**, në objektin e Komunës së Prizrenit, tek sporteli i kërkesave, ku çdo aplikim duhet të protokollohet, me emrin “Kërkesë për shfrytëzimin e Shtëpizave për Festat e Fundvitit”.

Data e njoftimit të bizneseve të përzgjedhura: **08.12.2023**. Më pas njoftoheni se kur duhet të vini ne Objektin e Komunës së Prizrenit për nënshkrimin e kontratës dhe procedurat e mëtejme.

### **Drejtoria për Turizmit dhe Zhvillimit Ekonomik**

Lirija Bytyqi - Drejtoreshë

